



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 20.02.2026, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me numër protokolli: DPKI-1710/25, për zyrtarin z. Hasan Ajeti, U.D. Drejtor i Burimeve Njerëzore, Shërbim Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

## A r s y e t i m

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të një denoncimi nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (*citojmë pjesë relevante nga kërkesa*):

*"[...] Hasan Ajeti është përmendur ndër emrat e gradimeve në SHSUK, si dhe punësimin e gruas së tij në administratë përfshirë edhe motrën e tij në zyrën ligjore të QKUK-së. Hasan Ajeti U.D. Drejtor i Burimeve Njerëzore në SHSKUK, ka punësuar bashkëshorten në konkursin për receptionist, ku në komision ka qenë znj. J.V. SHSKUK [...]"*

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore të saja sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka ndërmarr veprime dhe ka zhvilluar procedurë të hetimit administrativ, duke shqyrtuar dhe trajtuar vetëm pretendimet e ngritura për konflikt të mundshëm të interesit, sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Me qëllim të sqarimit të këtij rasti, Agjencia ka kërkuar nga Shërbim Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), dosjen e konkursit Nr. 1516, datës 10.06.2024, nr. referencës SHSKUK-05/2024, për pozitën receptionist, QKUK(shkresa zyrtare: DPKI-3283/25). Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pranuar nga SHSKUK, përgjigje bashkë me dokumentacionin dhe informatat e kërkuara.

Më pas, me qëllim të sqarimit të plotë të pretendimeve të raportuara, Agjencia ka realizuar një takim me zyrtarin z.Hasan Ajeti, U.D. Drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore të SHSKUK-së, me këtë rast i njëjti është njoftuar zyrtarisht për pretendimet e ngritura ndaj tij për konflikt të interesit. Gjatë takimit, z. Hasani ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë, e gjithashtu të njëjtat i ka përcjellë në Agjenci edhe në formë të shkruar.

Në deklaratën me shkrim të dërguar në Agjenci nga zyrtari z. Hasan Ajeti, theksohet se: *“Gjatë periudhës kur është punësuar bashkëshortja ime, unë kam ushtruar detyrën e U.D. Udhëheqës i Divizionit për Siguri dhe Shëndet në Punë në SHSKUK, gjë që dëshmohet dhe vërtetohet me vendimet përkatëse. Gjithashtu ju njoftoj se motra ime është e punësuar ne QKUK, për më tepër se 15 (pesëmbëdhjetë) vite”.*

Nga informatat që përmban kërkesa e raportuesit të rastit, sqarimet nga takimi i mbajtur, si dhe dokumentacioni i siguruar sipas detyrës zyrtare nga Agjencia, rezulton gjendja faktike si në vijim:

Shefi i Sektorit të Administratës përmes kërkesës së datës 04.03.2024, ka kërkuar nga sektori i personelit të QKUK-së, plotësimin e vendeve vakante dhe të nevojshme në Sektorin e Administratës për shpalljen e konkursit publik për pozitën: Zyrtar/e Administratës, Arkivist në klinika dhe Arkivin Qendror (Depon e Arkives), Punëtor Administrativ si dhe Receptonist;

Më datë 10.06.2024, SHSKUK ka publikuar konkursin Nr. 1516 për pozitën e punës me titull: 1. Inkasant; 2. Receptonist, me numër të Referencës SHSKUK-04/2024;

Sektori i Personelit të QKUK-së, me datë 16.07.2024, ka publikuar listën e kandidatëve që kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak që i plotësojnë kriteret sipas konkursit nr.1516, datë 10.06.2024, për pozitën 2. Receptonist (14 pozita);

Me vendimin Nr. 1/2182, të datës 30.07.2024, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK, ka formuar komisionin përzgjedhës sipas Konkursit Publik Nr. 1516/2, të datës 10.06.2024, për pozitën “Receptonist” në Sektorin e Administratës në QKUK, në përbërje A.Q.,J.V.,K.H.,K.G. dhe A.G.;

Me vendimin nr. 1/9107/24, të datës 22.11.2024, komision përzgjedhës publikon rezultatet përfundimtare të kandidatëve të pranuar për pozitën e punës: Receptonist (14 pozita);

Me datë 30.04.2024, me Vendimin Nr. 1/1171, të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së, z. Hasan Ajeti, caktohet Ushtrues i Detyrës Udhëheqës i Divizionit për Siguri dhe Shëndet në Punë pranë Administratës Qendrore në SHSKUK;

Ndërsa me datë 02.05.2025, me Vendimin Nr. 1/1867, të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së, z. Hasan Ajeti, caktohet Ushtrues Detyre Drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore të SHSKUK-së;

Me datë 17.05.2012, me Vendimin Nr. 2397, të Drejtorit Ekzekutiv të QKUK-së, znj. A.A. është caktuar në pozitën zyrtare ligjore në kuadër të Zyrës për Çështje Juridike të QKUK-së. Po ashtu me datë 23.05.2012, znj .A.A. ka nënshkruar akt emërimi për pozitën zyrtare ligjore në kuadër të Zyrës për Çështje Juridike.

Pas administrimit të provave dhe informacionit në dispozicion, konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia ka konstatuar se në rastin konkret *nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e situatës së konfliktit të interesit*, në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, për zyrtarin z. Hasan Ajeti përkitazi me pretendimin e ngritura nga raportuesi i rastit se në cilësinë e U.D. Drejtor i Burimeve Njerëzore në SHSKUK, ka punësuar bashkëshorten në konkursin për pozitën e punës recepsionist, për faktin se i njëjti gjatë periudhës së zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën e punës Recepsionist në QKUK, nuk ka ushtruar detyrën e UD. Drejtorit të Burimeve Njerëzore në SHSKUK, por ka ushtruar detyrat e punës si U.D. Udhëheqës i Divizionit për Siguri dhe Shëndet në Punë pranë Administratës Qendrore në SHSKUK, çka dëshmon se i njëjti nuk ka pasur rol vendimmarrës apo mbikëqyrës në këtë proces.

Kësisoj, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

*"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".*

Lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

*"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",*

si dhe me nënparagrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

*"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. [...]."*

Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definojnë nocionin vendimmarrje si:

*"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."*

Situata e konfliktit të interesit është i lidhur ngushtë me vendimmarrjen dhe/apo çastet paraprake të vendimmarrjes lidhur me ekzistencën e interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm në një çështje të caktuar, e që lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit, nuk është gjetur ndonjë element përmbajtësor që në kuptim të dispozitave të sipërcituara të jenë plotësuar kushtet kumulative, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo personave të afërm me të.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, bazuar në dokumentacionin në dispozicion (*vendimin për formimin e komisionit përzgjedhës, anëtar i komisionit të përzgjedhjes, nënshkrimi i kontratës së punës për kohë të pa caktuar për V.A*), konstaton se në kuptim të dispozitave të sipërcituara, z. Hasna Ajeti, nuk ka qenë pjesë e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes sa i përket pozitës recepcioniste ku është punësuar bashkëshortja e tij, prandaj në rastet kur mungon vendimmarrja nga zyrtari (*si kusht i domosdoshëm kumulativ*), përjashtohet situata e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Sa i përket pretendimit tjetër të raportuesit të rastit se z. Ajeti ka punësuar motrën e tij në Zyrën Ligjore, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe dokumentacionit përkatës rezulton se znj. A.A. është e punësuar në QKUK që nga viti 2012, në pozitën e zyrtares ligjore. Ky fakt është konfirmuar edhe gjatë deklaratimit të tij në takim, si dhe përmes dokumentacionit të administruar në procedurë, nga i cili rezulton se punësimi i znj. A.A. në QKUK nuk është realizuar në kohën kur z. Ajeti e ushtron detyrën e U.D. Drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore në kuadër të SHSKUK-së, e që për rrjedhojë nuk është gjetur asnjë provë që do të dëshmonte se i njëjti ka pasur ndikim apo përfshirje në procedurën e punësimit të saj.

Pretendimet tjera të ngritura nga raportuesi i rastit të cilat nuk ndërlidhen me konflikt të interesit e që janë jashtë kompetencave ligjore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, nuk janë trajtuar në këtë procedurë administrative.

**II.** Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative”*.

Prandaj, nga se u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit publik Hasan Ajeti
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

  
Drejtoria e Agjencisë për  
Parandalimin e Korrupsionit